



Prishtinë, 19 maj 2016
Kodi i ZRRE-së: V_812_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 14 paragrafi 6 dhe 7 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimi për Lëshimin e Njoftimit për Autorizimin Preliminar V-618-2014 të datës 29 prill 2014 për shoqërinë "Kelkos-Energy Peja" sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC Kuqishta 4.5 MW, HC Drelaj I. 4.6 MW, HC Drelaj II. 4.4 MW, HC Shtupeq 6.5 MW dhe HGU Rugova 40.5 MW, me kapacitet total të instaluar prej **60.5 MW**, njësitë gjeneruese që do të vendosen në lokacionin e lumëbardhi i Pejës, komunën e Pejës;
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Autorizimin Preliminar V-618-2014 të datës 29 prill 2014, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, HC Kuqishta 4.5 MW, HC Drelaj I. 4.6 MW, HC Drelaj II. 4.4 MW, HC Shtupeq 6.5 MW dhe HGU Rugova 40.5 MW, me kapacitet total të instaluar prej **60.5 MW**, njësitë gjeneruese që do të vendosen në lokacionin e lumëbardhi i Pejës, komunën e Pejës, të datë 27.04.2016 të shoqërisë "Kelkos-Energy Peja" sh.p.k., me adresë rruga "Ahmet Krasniqi" Blloku C1/b,15, Komuna e Pejës Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 19 maj 2016 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin e Autorizimit Preliminar V-618-2014 të datës 29 prill 2014, lëshuar shoqërisë "Kelkos-Energy" sh.p.k., për vazhdimin e zhvillimit të projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, HC Kuqishta 4.5 MW, HC Drelaj I. 4.6 MW, HC Drelaj II. 4.4 MW, HC Shtupeq 6.5 MW dhe HGU Rugova 40.5 MW, me kapacitet total të instaluar prej **60.5 MW**, njësitë gjeneruese që do të vendosen në lokacionin e lumëbardhi i Pejës, komunën e Pejës, edhe për gjashtë (6) muaj, gjegjësisht **deri me 29 tetor 2016**.

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 24.06.2013 nga shoqëria "Kelkos-Energy Peja" sh.p.k., kemi pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, në lokacionet: HC Kuqishta 4.5 MW, HC Drelaj I. 4.6 MW, HC Drelaj II. 4.4 MW, HC Shtupeq 6.5 MW dhe HGU Rugova 40.5 MW, të gjitha në komunën e Pejës.



- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmimeve të prezantuara nga shoqëria “Kelkos-Energy Peja” sh.p.k., ka vendosur se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V-618-2014 të datës 29 prill 2014.
- Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (2) dy vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqëria “Kelkos-Energy Peja” sh.p.k., do t’i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim Final duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- ZRRE me datë 13.07.2015 ka pranuar kërkesat për praninë në skemën mbështetëse për HC Kuqishta 4.5 MW, HC Drelaj I. 4.6 MW, HC Drelaj II. 4.4 MW, HC Shtupeq 6.5 MW dhe HGU Rugova 40.5 MW, të gjitha në komunën e Pejës.
- Bordi i ZRRE-së me datë 23 shkurt 2016 ka lëshuar vendimet V-793-2016 për HC Kuqishta 4.5 MW, V-794-2016 HC Drelaj I. 4.6 MW, V-795-2016 HC Drelaj II. 4.4 MW dhe V-796-2016 HC Shtupeq 6.5 MW, për praninë në skemën mbështetëse. Ndërsa për HC Rugova 40.5 MW, nuk është pranuar kërkesa për praninë në skemën mbështetëse.
- ZRRE me datë 27.04.2016 nga shoqëria “Kelkos-Energy Peja” sh.p.k., ka pranuar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V-618-2014 të datës 29 prill 2014, edhe për një afat shtesë, për mundësinë e kompletimit të aplikacionit.
- Shoqëria “Kelkos-Energy Peja” sh.p.k., në kërkesën e saj ka sqaruar se: që nga viti 2012 është duke u investuar në ndërtimin e hidrocentraleve në Kosovë. Fokusi kryesor kanë qenë **dy kaskadat e hidrocentraleve përgjatë Lumit të Deçanit dhe Lumit të Pejës (Gryka e Rugovës) në Kosovën perëndimore**. Ndërtimi i këtyre hidrocentraleve, të cilat ndodhen pjesërisht në **Zonat e Veçanta të Mbrojtura të Manastirit ortodokse serbe në Deçan dhe Patriarkales së Pejës** u bë i mundur vetëm nëpërmjet marrëveshjeve të sofistikuar me përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe, të mbështetur nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe lehtësuar nga Komuniteti Ndërkombëtar. Gjithashtu ka sqaruar se është nënshkruar kontrata e servitutit me komunën e Pejës dhe Patriarkalen e Pejës, Poashtu me themelimin e Parkut Kombëtarë në këtë rajon, kanë dalur disa detyrime dhe sfida të tjera që janë vendosur mbi projektet dhe punimet e ndërtimit.
- Shoqëria “Kelkos Energy Peja” sh.p.k., që nga marrja e autorizimit paraprak për ndërtimin e kaskadës në lumin e Pejës, ka qenë në bashkëpunim të ngushtë me MMPH, si institucioni kryesor për dhënien e lejes për të **adaptuar nga përvoja e projektit Deçanit në projektin e Pejës**. Prandaj KelKos Energy ka koordinuar procesin e aplikimit ngushtë me MMPH, veçanërisht Sekretarin e Përhershëm të saj dhe drejtuesit të Departamenteve.





- *Gjatë ecurisë së 2014/2015 ndryshimet e mëdha në vijim nga ana e MMPH-së detyruan Kelkos Energy peja Sh.p.k., që të rishikojë hartimin e projektit dhe dokumentacionin e aplikimit në thelb: Zbatimi i legjislacionit të ri të MMPH në lidhje me procedurat për leje të kombinuara Mjedisore, Ujërave dhe leje të ndërtimit. Me legjislacionin e ri, procedurat kanë ndryshuar plotësisht në krahasim me atë të projektit të Deçanit dhe dokumentacionet e kërkuara nga ana e Ministrisë kanë ndryshuar në thelb. Me një projekt të shkallës së kompleksitetit të kaskadës së lumit të Pejës (5 hidrocentrale të ndryshme me karakteristika të veçanta të projektimit), kjo kërkon disa muaj riprodhim/ndryshim të dizajnit ekzistuese konstruktiv, makinerive dhe pajisjeve elektrike.*
- *Si një hap tjetër dhe në koordinim me MMPH **dëgjimi public i projektit për lejen mjedisore** është planifikuar për gjysmën e dytë të majit. Gjatë 3-4 muajve në vijim procedurat e lejeve me MMPH do të përfundojnë me sukses, bazuar në dizajnin e rishikuar siç shpjegohet më sipër. Andaj, bazuar në këto të dhëna të paraqitur në kërkesën me shkrim ka kërkuar të lejohet shtyerja edhe për një afat të arsyeshëm, për vazhdimin e këtij projekti kompleks, e cila ka kaluar nëpër në rend të gjatë të ndryshimeve të koordinuara dhe të cilësisë, për të arritur në fund standardin e shquar mjedisor dhe pranimin nga institucionet relevante.*
- ZRRE pas analizimit të kërkesës për shtyerje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Autorizimit Preliminar, të lëshuar shoqërisë “Kelkos-Energy Peja” sh.p.k., për vazhdimin e zhvillimit të projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, HC Kuqishta 4.5 MW, HC Drelaj I. 4.6 MW, HC Drelaj II. 4.4 MW, HC Shtupeq 6.5 MW dhe HGU Rugova 40.5 MW, me kapacitet total të instaluar prej **60.5 MW**, për njësitë gjeneruese që do të vendosen në lokacionin e lumëbardhi i Pejës, komunën e Pejës, ka vlerësuar atë, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Pas skadimit të afatit të cekur në dispozitivin e këtij vendimi, vendimi V-618-2014 i datës 29 prill 2014, mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, **do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.**
- III. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krehar Bujupi, anëtar


Arsim Janova, anëtar


Qemajl Mustafa, anëtar


Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës
- Komunës së Pejë
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së